STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 20 maj 2013

GUVERNATORI NJOFTON 20 MILIONE DOLLARE NE FONDE PER INDUSTRINE E PESHKIMIT TE PREKUR NGA SENDI (SANDY)

Dollarët federalë të miratuar së fundmi do të ndihmojnë në rindërtimin e industrisë së peshkimit tregtar dhe argëtues

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) u bëri thirrje sot bizneseve bregdetare të peshkimit të dëmtuara nga Sendi (Sandy) që të bëjnë kërkesa për fonde të disponueshme nëpërmjet Programit të Fondeve për Industrinë Bregdetare të Peshkimit të Shtetit të miratuar së fundmi. Sipas programit, bizneset që kualifikohen do të jenë në gjendje të bëjnë kërkesa për fonde deri në 50,000 dollarë për të mbuluar humbjet e pakompensuara.

"Rajonet më të shkatërruara nga super stuhia Sendi (Sandy) janë gjithashtu pjesë thelbësore të industrisë së peshkimit të shtetit tonë, duke ndihmuar mijëra vende pune të vendit dhe duke krjiuar miliarda në veprimtari ekonomike," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Me mbërritjen e sezonit të pikut të peshkimit, jam duke drejtuar fonde të reja federale për të ndihmuar këtë industri të rëndësishme në Long Ajlënd (Long Island) dhe Stejtën Ajlënd (Staten Island) ndërsa punon për të arritur rimëkëmbjen e plotë."

Bizneset e peshkimit mund të bëjnë kërkesa tani duke shkuar tek http://nysandyhelp.ny.gov/sites/default/files/documents/coastal-fishing-industry_4.25.13.pdf ose duke telefonuar 1-855-NYS-SANDY. Bizneset e peshkimit që pësuan dëme dhe/ose vështirësi ekonomike si rezultat i uraganit Irenë (Irene) ose stuhisë tropikale Li (Lee) gjithashtu kualifikohen për fonde nëpërmjet programit. Programi prej 20 milionë dollarë, i krijuar për të ndihmuar në rimëkëmbjen e industrisë së peshkimit, ishte pjesë e Planit të Veprimit të Fondeve në Bllok për Zhvillimin e Komunitetit që të Rimëkëmbet nga Katastrofa të Shtetit, që mori miratim federal muajin e kaluar.

"Industria e peshkimit e Nju Jorkut (New York) është thelbësore për ekonominë tonë, duke ndihmuar vendet e punës," tha Presidenti, CEO & Komisioneri i Empire State Development Keneth Edëms (Kenneth Adams). "Këto fonde janë përkushtuar për të ndihmuar këtë industri vendimtare që të rimëkëmbet nga humbjet që pësoi gjatë Sendit (Sandy) dhe të rindërtohet më e fortë sesa më parë."

Stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi dëm të konsiderueshëm për vendet e peshkimit përgjatë vijës bregdetare të Nju Jorkut (New York). Vlerësohet se dëmet e industrisë bregdetare të peshkimit arritën në 77 milionë dollarë (58 milionë dollarë të sektorit të peshkimit argëtues të Shtetit dhe 19 milionë dollarë të sektorit të peshkimit tregtar të tij) për shkak të Sendit (Sandy).

Komisioneri i Departamentit të Ruajtjes Mjedisore (Department of Environmental Conservation Commissioner) Xho Martens (Joe Martens) tha, "Duke vizituar zonën e prekur nga Sendi (Sandy), pashë vetë dëmin që pësoi industria e peshkimit pas Sendit (Sandy). Këto fonde, të dhëna nga Guvernatori Kuomo (Cuomo), do të ndihmojnë që bizneset e peshkimit argëtues dhe tregtar të rimëkëmben dhe të rindërtohen. Vendet e peshkimit janë një motorr vendimtar ekonomik për ekonominë e shtetit dhe DEC vazhdon të bëjë gjithshka që mundet për të ndihmuar këtë industri."

"Industria jonë e peshkimit argëtues detar ra në gjunjë pas Sendit (Sandy), por jemi duke u rikthyer të fortë për sezonin e peshkimit të 2013-tës dhe këto fonde mund të ndihmojnë që të sigurojnë se jemi më të fortë se kurrë në sezonet e ardhshme. Peshkatarët e ujrave të kripura dhe pronarët e bizneseve detare të Nju Jorkut (New York) me të vërtetë e vlerësojnë udhëheqjen dhe ndihmën e madhe që Guvernatori Kuomo (Cuomo) dhe personeli i tij kanë dhënë pas Sendit (Sandy) dhe veçanërisht duke ndihmuar në përshpejtimin e këtij procesi të fondeve," tha Xhim Haçinson (Jim Hutchinson), Drejtor Administrativ i Aleancës së Peshkimit Argëtues, President i Federatës së Peshkimit si Sport të Nju Jorkut (President of New York Sportfishing Federation).

"Industria e peshkimit argëtues të NY u godit rëndë nga Sendi dhe kemi një rrugë të gjatë përpara drejt rimëkëmbjes. Disa janë duke rindërtuar nga zero, shumë janë duke u përpjekur për të kaluar përmes kohërave të vështira financiare, por TE GJITHE janë këmbëngulës dhe të vendosur për të rindërtuar komunitetet e peshkimit të NY. Ndërsa moti ngrohet dhe kryerradhët e gazetave harrohen, ata që nuk janë në llogore mund të harrojnë sesa punë ende mbetet për t'u bërë. Eshtë kaq inkurajuese të dimë se Guvernatori Kuomo (Cuomo) dhe personeli i tij nuk na kanë harruar dhe ende janë duke punuar shumë për të marë ndihmën financiare që i nevojitet kaq shumë industrisë së peshkimit argëtues. Këto fonde janë një hap i pare drejt atij qëllimi," tha Melisa Diërborn (Melissa Dearborn), Zëvendës/Presidente e Regal Marine Products.

Më 2011, industria e peshkimit tregtar e Shtetit krijoi 5 miliardë dollarë në shitje, duke kontribuar 1.8 miliardë dollarë në prodhimin bruto të shtetit dhe ndihmoi 42,000 vende pune anembanë ekonomisë më të gjërë. Industria e peshkimit argëtues detar e Shtetit krijoi 369 milionë dollarë në shitje, duke kontribuar 212 milionë dollarë në prodhimin bruto të shtetit dhe ndihmoi 3,000 vende pune anembanë ekonomisë më të gjërë.

"Peshkimi për argëtim dhe tregtar në ujin e kripur është një nga shumë thesaret e shkëlqyera të Long Ajlënd (Long Island). Eshtë pjesë e historisë sonë dhe për shumë njerëz është një mënyrë jetese. Një nga përparësitë kryesore të mia në detyrë ka qënë të punoj me Guvernatorin Kuomo (Cuomo), kolegët e mi të legjislativit dhe peshkatarët tanë në Long Ajlënd (Long Island) për të përmirësuar këtë industri. Pas

eleminimit së fundmi të Tarifës së Liçensës së Peshkimit në Ujra të Kripura, përgëzoj Guvernatorin për mbështetjen në disa hapa të ndryshëm përpara duke zbatuar Programin e Fondeve për Industrinë Bregdetare, i cili do të ndihmojë industrinë tonë të peshkimit që të rimëkëmbet nga pasojat shkatërruese të super stuhisë Sendi (Sandy)," tha Senatori Li Zeldin (Lee Zeldin).

"Industria e peshkimit argëtues siguron pothuajse 10,000 vende pune, kështu që është e rëndësishme që ky aspekt vendimtar i ekonomisë së përgjithshme të mbështetur tek deti të kthehet dhe të jetë në funksionim këtë sezon. Nga personeli në Departamentin e Ruajtjes Mjedisore të Nju Jorkut (New York Department of Environmental Conservation) në Long Ajlënd (Long Island) dhe deri lart në Albani (Albany), shumë përpjekje të mëdha janë kryer që ekonomia jonë vendore e mbështetur tek deti të veprojë përsëri pas pasojave shkatërruese nga Sendi (Sandy). Kjo mbështetje dhe ky vlerësim i pashembullt i vlerës së industrisë sonë të peshkimit argëtues pranohet me mirënjohje dhe na jep optimizëm për të ardhmen," tha Xhon Mantione (John Mantione), Zëdhënës, Shoqata Tregtare e Peshkimit me Grep të Nju Jorkut (New York Fishing Tackle Trade Association).

"Fondet Detare të NY (NY Sea Grant) mbetet e shqetësuar në lidhje me pasojat e vazhdueshme të uraganit Sendi (Sandy) mbi banorët dhe komunitetet tona bregdetare të prekura më rëndë. Personeli i Sea Grant ka punuar nga afër me industrinë e peshkimit, NYS DEC dhe agjenci të tjera qeveritare për të ndihmuar në perpjekjet e reagimit për ndihmë. Jemi duke inkurajuar pronarët e vegjël të bizneseve bregdetare që të marrin pjesë në programet e Guvernatorit Kuomo (Cuomo) të krijuara për të ndihmuar në rimëkëmbje dhe rindërtim, duke u kërkuar atyre të vizitojnë faqen në internet ose të kontaktojnë me zyrën tonë për të përcaktuar sesi të përdorin më mirë këto burime. Fondet Detare të NY (NY Sea Grant) është e përkushtuar për të punuar së bashku që t'i sjellim peshkatarët përsëri në breg dhe të ndihmojmë në rigjallërimin e komuniteteve bregdetare," tha Xhejms Emërmen (James Ammerman), Drejtor, Fondet Detare të Nju Jorkut (New York Sea Grant).

Bizneset e peshkimit mund të kualifikohen për fonde dhe ndihmë financiare shtesë nëpërmjet programit të rimëkëmbjes së bizneseve të vegjël të Shtetit nëse humbjet e pakompensuara kapërcejnë 50,000 dollarë ose për fonde të posatçme të mbrojtjes për t'i ndihmuar që të parandalojnë dëm të ngjashëm nga stuhi të ardhshme.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418